

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE			
№ Projektit / Proj. No:	SP-02	№ i Protokollit / Prot. No:	7362-2/24
№ i Engjësës / Re. Struktura / No. Pages:	03	Data / Datum / Date:	20.08.24
PRISHTINË / A			No. 1



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	03.07.2024
REFERENC-Ë:	23/7362/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Ekon Kos", Sh.p.k. Istog Baza për Prodhimin e Betonit- Istog.
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për ndërprerje të procedurës administrative

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për vazhdim të Lejes Mjedisore, operatorit "Ekon Kos", Sh.p.k. Istog, me nr.port. 23/7362/MMPHI, për veprimtarinë: Baza për Prodhimin e Betonit, Istog.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

- Vendimi për ndërprerje të procedurës administrative për operatorin, "Ekon Kos", Sh.p.k. Istog, për veprimtarinë: Baza për Prodhimin e Betonit, Istog.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 23/7362/MMPHI
Datë: 03.07.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe neni 9 paragrafi 1.4 i Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Operatorit, "Ekon Kos", Sh.p.k. Istog, i Ndërpritet **procedura administrative**, për veprimtarinë : Baza për Prodhimin e Betonit- Istog në ngastrën, nr. P- 70806020-01327-1, zona kadastrale, Istog.

A r s y e t i m

Pas pranimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin, "Ekon Kos", Sh.p.k. Istog për veprimtarinë: Baza për Prodhimin e Betonit, Istog, në ngastrën, nr. P-70806020-01327-1, zona kadastrale, Istog, Komisioni për shqyrtimin e kërkesës për leje Mjedisore ka kontrolluar dokumentacionin dhe në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022, ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumenteve si në vijim:

- Lejen për aktivitete të veçanta nga KPMM;

Komisioni për Leje Mjedisore ne takimin e mbajtur të datës: dt. 03.07.2024, konstatoi se operatori "Ekon Kos", Sh.p.k. Istog, Baza për Prodhimin e Betonit, nuk i plotëson kriteret e parapara për fillimin e shqyrtimit të kërkesës për pajisje me Leje Mjedisore, pasi qe nuk e ka kompletuar dokumentacionin e cekur me lartë në afatin kohorë të përcaktuar nenin 10 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, i ndërpritet procedura administrative për pajisje me Leje.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, mbyll procedurën administrative në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.



Izedin Bytyqi

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi iu dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Istog;
- DMMU-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.